

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6319  
E hënë, 24 maj 2021  
çmimi 0.40 €

Mblidhen rreth 2 000  
nënshkrime për faljen e  
borxheve të pandemisë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SMAJL LATIFI | FAQE 4-5

## QEVERIA KURTI DO TË JETË VAZHDIMËSI E QEVERIVE TË TJERA



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë Kosovës (AAK), Smajl Latifi, nuk ka pritje të mëdha nga qeveria Kurti. Ai ka bërë me dije se kjo qeveri do të jetë vazhdimësi e

qeverive të kaluara. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Latifi ka deklaruar se Kurti do ta ketë shumë vështirë për t'i realizuar zotimet e programit

qeverisë. Kryetari i Komunës së Rahovecit ka kritikuar qeverinë për anulimin e memorandumeve të mirëkuptimit me komunat, duke i vënë në vështirësi serioze

### AKTUALE



ZYRAT E QEVERISË NË GAZA  
PRITET TA RINISIN PUNËN F. 2



"DEFENDER EUROPE 21"  
NË TIRANË, FORCAT AMERIKANE  
DHE ATO SHQIPTARE  
TREGOJNË FORCËN F. 4

NË KIZHEVAK GJENDEN MBETJE  
MORTORE TË VIKTIMAVE TË  
MASAKRËS SË REZALLËS F. 5

PËRPLASJE NË MES TË POLICISË  
DHE BANORËVE NË SHIPASHNICË  
TË KAMENICËS PËR MBYLLJEN E  
NJË SHKOLLE F. 7

### EKONOMI



KOSOVA LË ANASH  
ENERGJINË E GJELBËR F. 9

142 092 PËRFITUES NGA SKEMA  
E PENSIONEVE BAZË F. 9



ISH-AVOKATI  
I GOTOVINËS  
AKREDITOHET  
NGA SPECIALJA,  
PRANON EMËRIMIN  
MBROJTËS  
I THAÇIT F. 3

PËR TË DYTËN DITË ME  
RADHË KOSOVA NUK  
REGJISTRON ASNJË  
VIKTIMË NGA COVIDI F. 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Zyrat e qeverisë në Gaza pritet ta rinisin punën

**GAZA, 23 MAJ** - Zyrat e qeverisë në Gaza do ta rinisin punën më 23 maj, teksa armëpushimi ndërmjet Izraelit dhe grupit militant Hamas po respektohet, tha një zëdhënës lokal palestinez.

Aktivitetet e qeverisë ishin ndërprerë pasi më 10 maj nisën sulmet ajrore të Izraelit, pasi Hamasi hodhi raketat e para drejt Izraelit nga Jerusalemi.

Izraeli tha se sulmet ajrore kishin për cak infrastrukturën ushtarake të Hamasit, por nga to është shkaktuar dëm edhe në ndërtesat rezidenciale, në ndërtesat shëndetësore dhe ndërtesa të tjera publike.

Armëpushimi ndërmjet militantëve palestinezë dhe Izraelit po respektohet, teksa konvojat e para me ndihmë humanitare kanë arritur në

Rripin e Gazës.

Armëpushimi, që nisi në orët e para të 21 majit, erdhi pasi ndërmjetësuesit egjiptianë po kërkojnë që të arrijnë një marrëveshje me afatgjatë.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve i Bashkuara më 22 maj bëri thirrje për ndihmë të menjëhershme për popullatën në Gaza.

Anëtarët e Këshillit të Sigurimit përmes një deklarate theksuan "nevojën e menjëhershme për ndihmë humanitare për popullatën civile palestineze, veçanërisht në Gaza". Ata, po ashtu, theksuan rëndësinë e arritjes së një "marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të paqes, e bazuar në vizionin e rajonit, ku dy shtete demokratike, Izraeli dhe Palestina, do të jetojnë pranë njëri-tjetrit në paqe dhe



me kufij të sigurt dhe të njohur ndërkombëtarisht".

Nuk kishte raportime për hedhje të raketave nga Hamasi apo për sulme ajrore nga Izraeli më 22 maj, edhe pse më 21 maj kishte pasur përplasje mes policisë izraelite dhe protestuesve palestinezë në Jerusalem.

Një zyrtare e lartë e OKB-së, që qëndroi në Rripin e Gazës më 22 maj, paralajmëroi se ka rrezik të shëndetit, pasi shtëpitë, rrugët dhe infrastruktura tjetër ose janë dëmtuar ose janë shkatërruar plotësisht. "Të gjithë duhet të përmbahen dhe të mos përfshihen në asnjë lëvizje provokuese", tha Lynn

Hasting, koordinatore humanitare e OKB-së për territoret palestineze.

Më 21 maj Egjipti dërgoi një delegacion në Izrael për të diskutuar për mënyrat se si të përforcohet marrëveshja e armëpushimit, përfshirë këtu edhe ndihmën për palestinezët në Gaza, thanë zyrtarët e Hamasit për agjencinë "Reuters".

Agjencitë ndërkombëtare të lajmeve kanë raportuar se sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, në javën e ardhshme do t'i vizitojë Izraelin dhe Bregun Perëndimor.

Autoriteti Palestinez, që udhëhiqet nga Mahmud Abbas, kontrollon zonat e banuara nga palestinezët në Bregun Perëndimor, por ka pak ndikim në Gaza, qytet që udhëhiqet nga lëvizja Hamas.

## Shkupi merr mbështetje nga Austria, Çekia dhe Sllovenia për bisedimet me BE-në

**SHKUP, 23 MAJ** - Maqedonia e Veriut ka marrë mbështetje për nisjen e bisedimeve me Bashkimin Evropian nga Austria, Republika Çeke dhe Sllovenia, një ditë pasi Bullgaria tha se do të vazhdojë të përdorë të drejtën e vetos për ta bllokuar anëtarësimin e Shkupit zyrtar.

Ministrat e Jashtëm të këtyre tri shteteve shprehën mbështetjen e tyre për nisjen e bisedimeve për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, duke thënë se çështjet e ndara bilaterale nuk duhet ta bllokojnë zgjerimin e BE-së.

Bullgaria ka thënë se nuk e ka ndërmend që ta heqë veton për nisjen e bisedimeve mes Maqedonisë së Veriut dhe BE-së për shkak të çështjeve kontestuese që ka me Shkupin sa i përket gjuhës dhe historisë. Sofja, që i është bashkuar BE-së më 2007, dëshiron që Shkupi ta



pranojë se identiteti dhe gjuha maqedonase kanë rrënjë bullgare.

Për ta miratuar kornizën e nisjes së bisedimeve me ndonjë shtet aspirues, kërkohet votë unanime nga të gjithë anëtarët e BE-së.

Ministri i Jashtëm i Austrisë, Alexander Schallenberg, ai çek, Jakub Kulhanek dhe kryediplomati i Sllovenisë, Anze Logar, arritën në Shkup për ta ofruar mbështetjen e tyre për nisjen e bisedimeve, që është paraparë të nisin në qershor.

Këta tre ministra pritet që më 23 maj ta vizitojnë edhe Shqipërinë.

Kulhanek tha se "nuk është fer" për një shtet anëtar të BE-së që ta bllokojë procesin për shkak të çështjeve bilaterale. "Kjo është një kohë kruciale, nuk duhet të

lejojmë që procesi të ngeçë për shkak të këtyre kërkesave", tha ai.

Shumë shtete në Perëndim i bëjnë thirrje BE-së që ta përshpejtojë procesin e bisedimeve për anëtarësim, pasi thonë se anëtarësimi i shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor në bllokun evropian, është mënyrë për ta luftuar ndikimin e Ruisë dhe Kinës në rajon.

Shkupi kishte aplikuar fillimisht për anëtarësim në BE më 2004 dhe kishte marrë vlerësim pozitiv nga Komisioni Evropian më 2005.

Maqedonia e Veriut arriti marrëveshje me Greqinë lidhur me emrin, duke i dhënë fund një kontesti pothuajse tridekadësh. Shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor: Serbia, Mali i Zi, Kosova dhe Bosnjë e Hercegovina janë në faza të ndryshme në rrugën e tyre drejt anëtarësimin në BE.

## Evakuohen mijëra persona pas shpërthimit të vullkanit në Kongo

**KONGO, 23 MAJ** - Mijëra persona janë evakuuar nga shtëpitë e tyre pasi gjatë natës shpërtheu një vullkan në Republikën Demokratike të Kongos. Vullkani në Malin Nyiragongo shpërtheu dhe banorët e qytetit Goma u evakuuan dhe autoritetet raportuan se llava që u lirua nga vullkani ka arritur shumë pranë qytetit, por më pas ka ndaluar rrjedhja e saj.

Ky qytet gjendet 10 kilometra nga vullkani dhe ka popullsi prej rreth dy milionë banorësh.

Aktualisht nuk ka raportime për viktima dhe është e paqartë se sa shtëpi mund të jenë shkatërruar nga shpërthimi i vullkanit. "Autoritetet lokale kanë monitoruar gjatë natës shpërthimin e vullkanit dhe rrjedhja e llavës ka humbur

intensitetin", ka thënë zëdhënësi i Qeverisë së Kongos, Patrick Muyaya.

Për herë të fundit ky vullkan kishte shpërthyer më 2002, duke vrarë 250 persona dhe duke lënë të pastrehë 120 mijë persona të tjerë. Vullkani Nyiragongo është një prej vullkaneve më aktive në botë dhe konsiderohet si një prej më të rrezikshmeve.





# Ish-avokati i Gotovinës akreditohet nga Specialja, pranon emërimin mbrojtës i Thaçit

PRISHTINË, 23 MAJ (ER) - Gregory W. Kehoe do të jetë avokati i ri i ish-presidentit Hashim Thaçi në Gjykatën Speciale. Kehoe do ta zëvendësojë avokatin David Hooper i cili ishte mbrojtës i Thaçit në procedurën e deritanishme paragjyqësore. Dhomat e Specializuara të Gjykatës tashmë e kanë vendosur emrin e Kehoe në listën e avokatëve të akredituar të këtij institucioni. Me më shumë se 30 vjet përvojë, Gregory W. Kehoe ka një praktikë kombëtare dhe ndërkombëtare që përqendrohet në përfaqësimin e individëve, korporatave dhe institucioneve financiare. Kjo përfshin përfaqësimin para gjykatave federale, shtetërore dhe ndërkombëtare. Kehoe ka përfaqësuar edhe ish-gjeneralin kroat Ante Gotovina deri në pafajësinë e tij të plotë para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Kehoe, gjithashtu, ka përfaqësuar ish-gjeneralin Mohammed Hussein Ali përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve,

gjë që çoi në rrëzimin e të gjitha akuzave që rëndonin mbi të.

Kehoe ka punuar në Departamentin e Drejtësisë në ShBA si prokuror për mbi 20 vjet me çështje të ndryshme të vendosura në Amerikë, Evropë, Azi dhe Amerikën e Jugut. Ndërsa ka shërbyes edhe si ndihmës i avokatit të shtetit të ShBA-së. Ai ishte përgjegjës për ndjekjen penale të një numri çështjesh të profilit të lartë që përfshinin institucionet financiare dhe akuzat e mashtrimit të korporatave si dhe akuzat për raketim.

Kehoe, gjithashtu, ka drejtuar ekipin e avokatëve dhe hetuesve që këshilluan Tribunalin Special të Irakut, një gjykatë ad hoc e formuar për të ndjekur penalisht Saddam Hussein dhe anëtarët e ish-regjimit të tij.

Kehoe ka shkollim të lartë në fushën e drejtësisë dhe ka çmime të shumta dhe mirënjohje për punën e tij në çështjet e drejtësisë.

Më 19 maj është mbajtur konferenca e pestë statusore ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë. Mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së ka kritikuar Zyrën e



Prokurorit të Specializuar. Avokatët e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi kanë thënë se mbajtja e klientëve të tyre në paraburgim derisa prokuroria ende vazhdon hetimet paraqet shkelje të të drejtave të njeriut. Në konferencën e pestë statusore

ata kanë vlerësuar se derisa prokuroria vazhdon hetimet dhe nuk është gati, klientët e tyre duhet të lirohen nga paraburgimi përkohësisht. ZPS-ja ka deklaruar se po vazhdon nxjerrjen e materialeve, por mbrojtja është ankuar se nuk po u jep informacione të plota për

dokumentet që po ua dorëzon. Dhomat e Specializuara kanë njoftuar se më 28 maj do të mbahet seanca e radhës për rastin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinaj.

Po më 9 qershor do të mbahet seanca e radhës edhe ndaj ish-epropolit të UÇK-së, Salih Mustafa.

## Mblidhen rreth 2 000 nënshkrime për faljen e borxheve të pandemisë



PRISHTINË, 23 MAJ - Partia Socialdemokrate (PSD) ka organizuar një peticion për qytetarë me moton "Të falen gjobat e pandemisë". Për dy ditë PSD-ja ka

mbledhur rreth 2 000 nënshkrime, ndërsa kjo parti e cila ndodhet jashtë Kuvendit të Kosovës, pas mbledhjes së 10 000 nënshkrimeve të qytetarëve,

do ta dorëzojë në Kuvend një projektligj për faljen e 200 mijë gjobave të qytetarëve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Nol Nushi nga PSD-ja ka

thënë për "KosovaPress" se falja e gjobave të qytetarëve dhe ndërmarrjeve nxjerr përfitues qytetarët.

Nushi ka thënë se edhe pozita duhet të votojë këtë

projektligj pasi që votoi 11 milionë euro për rrymën e serbëve në veri të vendit. "Grupi prej 10 000 qytetarëve mund të paraqesë iniciativë ligjore apo projektligj të cilën e dorëzon në Kuvendin e Kosovës dhe pastaj shkon në procedura të rregullta të Kuvendit për t'u trajtuar në seancën parlamentare. Fokusi kryesor janë personat fizikë, mirëpo ne i kemi përfshirë edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që kategorizohen me ligjet e Kosovës. Nga 200 000 e më shumë gjoba që janë shpërndarë, 90 për qind e tyre janë ndaj personave fizikë. Në rast se ky ligj miratohet në Kuvend, që unë besoj se do të miratohet, përfitues do të jenë qytetarët", është shprehur Nushi.

Përmes mbledhjes së nënshkrimeve do të kërkohet anulimi i këtyre gjobave për periudhën 15 mars 2020 - 15 maj 2021.





FLET PËR "EPOKËN E RE", SMAJL LATIFI

# Qeveria Kurti do të jetë vazhdimësi e qeverive të tjera

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë Kosovës (AAK), Smajl Latifi, nuk ka pritje të mëdha nga qeveria Kurti. Ai ka bërë me dije se kjo qeveri do të jetë vazhdimësi e qeverive të kaluara. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Latifi ka deklaruar se Kurti do ta ketë shumë vështirë për t'i realizuar zotimet e programit qeverisës. Kryetari i Komunës së Rahovecit ka kritikuar qeverinë për anulimin e memorandumeve të mirëkuptimit me komunat, duke i vënë në vështirësi serioze

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 MAJ - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë Kosovës (AAK), Smajl Latifi, ka thënë se qeveria Kurti do ta ketë shumë vështirë t'i realizojë zotimet e programit qeverisës. Ai

ka vlerësuar se kjo qeveri nuk do të dallojë shumë nga qeveritë e kaluara.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Latifi ka thënë se në programin qeverisës të prezantuar në Kuvendin e Kosovës nuk ka asgjë konkrete. "Është tepër e vështirë, për të

mos thënë e pamundur, për ta realizuar qeveria programin e saj dhe zotimet që ka paraparë. Mendoj se kjo qeveri do të jetë një vazhdimësi e qeverive të kaluara. Ne kemi dëshirë që t'i realizojmë të gjitha premtimet dhe zotimet që i ka dhënë para opinionit. Por, duke parë

programin e qeverisë të cilin e kam lexuar, nuk ka asgjë konkrete", ka thënë Latifi.

Ai ka deklaruar se në dy muajt e parë të kësaj qeverie është parë se nuk do të mund t'i realizojë pritjet e qytetarëve. "Në bazë të asaj që është parë, nuk kemi shumë veprime të veçanta. Pra, nuk ka hapa, vendime të rëndësishme që do të kishin ndonjë impakt në qeverisjen lokale dhe në jetën e qytetarëve. Natyrisht se qytetarët kanë votuar për këtë qeveri, sepse kanë pritur shumë më tepër. Në këtë mënyrë është pritur që edhe në ditët e para kjo qeveri të ndërmarrë veprime që do të kishin impakt në rritjen e

mirëqenies ekonomike dhe sociale të qytetarëve. Por, të shohim", ka thënë ai.

Në këtë intervistë Latifi ka folur edhe për dialogun me Serbinë. Sipas tij, Kurti do ta ketë vështirë t'i mbajë në këtë proces parimet që i ka proklamuar sa ishte në opozitë. "Z. Kurti shumë herë ka përsëritur qëndrimin se fillimisht do të ketë negociata me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, tek pastaj do të ketë negociata me Serbinë. Pastaj, ai ka thënë se dialogu do të jetë me parime. Në mënyrë të rregullt ai e ka përsëritur se Kosova duhet të vendosë kushte për dialogun me Serbinë dhe jo të shkohet në këtë proces vetëm pse dikush e

## Në Kizhevak gjenden mbetje mortore të viktimave të masakrës së Rezallës

Prishtinë, 23 maj - Në Kizhevak të Serbisë është konfirmuar ADN-ja e mbetjeve mortore të zhvarrosura. Nga Komisioni Qeveritar për të Pagjeturit kanë konfirmuar për "KosovaPress" se iu përkasin viktimave të masakrës së

Rezallës, të ndodhur më 5 prill 1999. Kushtrim Gara nga Komisioni Qeveritar për të Pagjeturit ka thënë se vendndodhja e varrezës masive në Kizhevak është prioritet. "Në bazë të raporteve të ADN-së mbetjet mortore të zhvarrosura deri

më tani iu përkasin viktimave të masakrës së Rezallës, 5 prill 1999", ka thënë Gara. Ai ka bërë me dije se gjatë këtij viti do të ketë gërmime edhe në Prizren, Gjakovë dhe ka mundësi rikthimi në Mitrovicë.





këtij uniteti?

**Latifi:** Sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, kryeministri është përgjegjës për çështjen e dialogu me Serbinë dhe arritjen eventuale të marrëveshjes ligjrisht të detyrueshme Kosovë-Serbi. Meqenëse kjo është një temë e ndjeshme dhe serioze, atëherë është mirë që kryeministri fillimisht ta ketë një platformë për dialogun me Serbinë në të cilën do të mund të shihen se cilat janë parimet dhe temat. Pra, të shihet se cila është shtylla kurrizore dhe skeleti për t'iu qasur kësaj problematike serioze siç është dialogu me Serbinë i cili do të ndërmjetësohet nga BE-ja. Ju e dini se AAK-ja ka konstatuar se dialogu me Serbinë është i nevojshëm dhe i rëndësishëm dhe ky proces duhet të zhvillohet vetëm në drejtim të njohjes reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Siç po shihet, kjo çështje është prioritet i qeverisë dhe i bashkësisë ndërkombëtare. Në frymën e kësaj, ne duhet të shohim se cila është agjenda e qeverisë, cilat janë temat dhe cila është qasja e qeverisë ndaj këtij dialogu. Këtë qasje për neve dhe publikun duhet ta tregojë vetë kryeministri Kurti.

**“Epoka e re”:** Kryeministri Kurti vazhdimisht ka kritikuar rrjedhën e deritanishme të dialogut me Serbinë. Ai është zotuar se do të bëjë një dialog ndryshe. Sa besoni se kjo qeveri do të bëjë më shumë se qeveritë e tjera në këtë proces?

**Latifi:** Z. Kurti shumë herë ka përsëritur qëndrimin se fillimisht do të ketë negociata me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, pastaj do të ketë negociata me Serbinë. Pastaj, ai ka thënë se dialogu do të jetë me parime. Në mënyrë të rregullt ai e ka përsëritur se Kosova duhet të vendosë kushte për dialogun me Serbinë dhe jo të shkohet në këtë proces vetëm pse e fton dikush Kosovën. Se a do të mund ta mbajë këtë qasje z. Kurti mbetet të shihet. Dëshira jonë është që ta mbajë këtë qasje. Është shumë e rëndësishme që Kosova ta përmbyllë këtë proces me një marrëveshje përmes së cilës Serbia e njeh Kosovën pa ia

cenuar në asnjë mënyrë sovranitetin dhe integritetin territorial. Është shumë e rëndësishme që në këtë proces të jenë pjesë e tavolinës së bisedimeve. Ne nuk jemi që të bëhet një marrëveshje shpejt e shpejt, e cila mund të jetë e dëmshme.

**“Epoka e re”:** Janë bërë rreth dy muaj që qeveria Kurti ka marrë detyrën. Cili është vlerësimi juaj për punën e deritashme të kësaj qeverie?

**Latifi:** Pavarësisht se ndoshta është herët të vlerësohet puna e kësaj qeverie, por në bazë të asaj që është parë, nuk kemi shumë veprime të veçanta. Pra, nuk ka hapa apo vendime të rëndësishme që do të kishin ndonjë impakt në qeverisjen lokale dhe në jetën e qytetarëve. Natyrisht se qytetarët kanë votuar për këtë qeveri, sepse kanë pritur shumë më tepër. Në

këtë mënyrë është pritur që edhe në ditët e para kjo qeveri të ndërmarrë veprime që do të kishin impakt në rritjen e mirëqenies ekonomike dhe sociale të qytetarëve. Por, të shohim.

**“Epoka e re”:** Si kryetar komune keni ndonjë vërejtje për punën e deritanishme të qeverisë?

**Latifi:** Natyrisht se si komunë kemi vërejtjet tona. Ne nuk kemi shumë komunikim me ministrinë e linjës. Pastaj, kjo qeveri ka anuluar memorandumet që janë nënshkruar për këtë vit buxhetor. Dihet se ato memorandumet bazën e kanë në Ligjin për Buxhet, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës para se të shpërndahet legjislatura e kaluar. Anulimi në mënyrë të njëanshme i këtyre memorandumëve natyrisht se i vënë në vështirësi serioze komunat e Kosovës, sepse ato memorandumet kanë

paraparë financimin e projekteve konkrete me ministrinë e linjave të caktuara.

**“Epoka e re”:** Qeveria e ka paraqitur programin në Kuvend. Pritni që të realizohen ato zotime?

**Latifi:** Është tepër e vështirë, për të mos thënë e pamundur, ta realizojë qeveria programin e saj dhe zotimet që ka paraparë. Mendoj se kjo qeveri do të jetë një vazhdimësi e qeverive të kaluara. Ne kemi dëshirë që t'i realizojmë të gjitha premtimet dhe zotimet që i ka dhënë para opinionit. Por, duke parë programin e qeverisë të cilin e kam lexuar, nuk ka asgjë konkrete. Shembull te pjesa e programit për bujqësi dhe zhvillim rural nuk ka afate konkrete se brenda çfarë kohe mund të realizohen ato zotime. Pra, nuk përmenden as metodat apo rrugët se si do të realizohen ato zotime që janë të shkruara.

## “Defender Europe 21” në Tiranë, forcat amerikane dhe ato shqiptare tregojnë forcën



**TIRANË, 23 MAJ (ER)** - Në sheshin “Nënë Tereza” të dielën është mbajtur dita e hapur e Forcave të Armatosura shqiptare në kuadër të stërvitjes së përbashkët me trupat amerikane “Defender Europe 21”. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin ambasadorja amerikane në Shqipëri, Yuri Kim, kryemi-

nistri Edi Rama, presidenti Ilir Meta si dhe ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi. “Defender Europe 21” është stërvitja më e madhe ushtarake që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore. Me mijëra trupa nga ShBA, por edhe aleatë të tjerë të NATO-s,

disa prej të cilëve janë të përfaqësuar po demonstrojnë një rritje të aftësive ushtarake për të bashkëpunuar së bashku si aleatë ushtarakë. Në këtë stërvitje janë angazhuar mbi 28 mijë ushtarë, shumica e të cilëve janë amerikanë. Në këtë ngjarje po merr pjesë edhe FSK-ja.

## Arrijnë edhe 60 mijë doza të vaksinës ‘Sinovac’ në Shqipëri

**TIRANË, 23 MAJ (ER)** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook”, ka bërë me dije se sapo kanë arritur edhe 60 mijë doza të vaksinës ‘Sinovac’ në Aeroportin “Nënë Tereza”. “Aeroporti “Nënë Tereza”. Sapo

kanë mbërritur edhe 60 mijë doza të vaksinës ‘Sinovac’, teksa presim të hënën sërish doza të tjera të vaksinës ‘Pfizer’, për ta vazhduar pa u ndalur planin tonë të vaksinimit masiv, për një sezon turistik, përtej pandemisë”, ka shkruar Rama.





## Tahiri bën homazhe me rastin e 22-vjetorit të masakrës së Vushtrrisë

VUSHTRRI, 23 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, së bashku me shoqatat e dala nga lufta dhe me zyrtarë të tjerë komunalë, kanë bërë homazhe në nderim të 68 viktimave të vrarë në masakrën e 22

majit 1999 në Vushtri. Kryetari Tahiri në emër të familjarëve ka kërkuar drejtësi duke thënë se vetëm drejtësia është ajo që sadopak e zbut dhimbjen për familjarët e të gjithë martirëve të Vushtrrisë. "Sot është dita e

dhimbjes së madhe për qytetin e Vushtrrisë dhe çdo ditë që kalon prej asaj dite të kobshme, më shumë sesa dhimbja dhe më e madhe për familjarët dhe për mua si kryetar komune është mllëfi që nuk ka drejtësi", ka thënë Tahiri.



## Të rinjtë e Kamenicës dhe të Ferizajt përmes pikturave paraqesin diversitetin në përgjithësi

KAMENICË, 23 MAJ (ER) - Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në Kamenicë, në bashkëpunim me Mural Fest Kosovo dhe financim të UNMIK-ut, kanë organizuar një punëtori me të rinjtë e Kamenicës dhe të Ferizajt, ku përmes pikturave është paraqitur diversiteti në përgjithësi.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se ndihet jashtëzakonisht mirë që në Kamenicë po realizohet kjo lloj punëtorie e cila i jep edhe më shumë ngjyra Kamenicës. "Ndihem jashtëzakonisht mirë që jam në mesin e këtyre të rinjve, të cilët po bëjnë vepra tejet të mira. Normalisht, për këtë u jam mirënjohës Mural Fest Kosovo që po na mbështet

vazhdimisht dhe po na ndihmon që Kamenica të shndërrohet në qytet edhe më të bukur përmes artit, e sidomos më divers për qytetarët", ka deklaruar ai. Sipas tij, Kamenica është një nga qytetet me bashkëjetesën më të mirë e tolerante në mes të gjitha komuniteteve që jetojnë këtu.

Ndërkaq drejtori i DKRS-së, Arianit Ibrahim, ka pohuar se angazhimi i tij në të mirën e qytetit e të rinjve do të jetë përherë i pashmangshëm, duke u ofruar atyre kushte më të mira e aktivitete nga më të ndryshmet. E Lebibe Topalli nga Mural Fest Kosovo tha se është kënaqësi të gjendet mes të rinjve nga Ferizaj e Kamenica, e gjithashtu falënderoi UNMIK-un për financimin e këtij projekti.



## Nënkryetari i Malishevës inspekton punimet në disa projekte



MALISHEVË, 23 MAJ (ER) - Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka inspektuar punimet në disa projekte që janë në realizim e sipër në këtë komunë. Ai ka parë nga afër punimet për rregullimin e hapësirës përgjatë shtratit të lumit Mirusha, ndërtimin e zveshtoreve dhe tribunave në stadiumin e qytetit, meremetimin e lapidarit në Gurbadh dhe rregullimin e fushës së volejbollit në shkollën e fshatit Lladrovç.

Gjatë këtyre inspektimeve nënkryetari Berisha ka kërkuar nga punëkryesi zbatimin në përpikëri të projekteve, planeve të punës dhe cilësi në realizimin e

tyre. "Cilësia në punime, zbatimi i dinamikës së punimeve dhe respektimi i paramasave sipas projekteve janë themelore, prandaj kam kërkuar nga punëkryesit që në përpikëri t'i zbatojnë këto kritere. Po ashtu, kam kërkuar që të përshejtohen apo të mos ketë vonesa, sidomos për ndërtimin e tribunave për stadiumin e qytetit për shkak të natyrës së projektit dhe nevojës që duhet të ndërtohen shpejt, por në asnjë mënyrë të shmanget projekti dhe cilësia e punimeve", ka thënë Berisha, duke shtuar se këto janë disa nga projektet e shumta që janë duke u realizuar në tërë territorin e Komunës së Malishevës.

## Çështje javësh lëshimi në funksion i fabrikës së ujit në Talinoc të Muhaxherëve

FERIZAJ, 23 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka bërë me dije se është çështje javësh përfundimi i punimeve dhe lëshimi në funksion i fabrikës së ujit në Talinoc të Muhaxherëve. Ai ka thënë se ky është një projekt strategjik e jetësor që i jep

zgjdhje furnizimit me ujë të pijshëm fshatrave Sojevë, Dardani, Zllatar, ndërsa rrit kapacitetin e furnizimit me ujë të pijshëm edhe për fshatrat Talinoc i Muhaxherëve, Fshat i Vjetër, Bibaj dhe zona të tjera të qytetit.





## Për të dytën ditë me radhë Kosova nuk regjistron asnjë viktimë nga Covid

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 MAJ - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 3 012 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 31 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve nuk është raportuar asnjë rast i të vdekurit.

Numri total i rasteve pozitive me Covid është 107 244 raste nga 591 824 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2 239 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 95 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 101 374 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 631.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 9 raste, Gjilan 5 raste, Mitrovicë 3 raste, Podujevë 3 raste, Ferizaj 2 raste, Prizren 2 raste, Vushtrri 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Dragash, Fushë-Kosovë, Kaçanik dhe Obiliq.

Në klinikat Covid të QKUK-së dhe në spitalet e përgjithshme, në bazë të raportit të punës për datën 23 maj 2021, po trajtohen 212 persona.

Në Kosovë është në zhvillim e sipër faza e dytë e vaksinimit, ku bëjnë pjesë personat e moshës 65-79 vjeç.

Në fazën e parë që ka nisur në fund të marsit, përparësi u është dhënë punonjësve shëndetësorë dhe personave mbi 80 vjeç.

Në fazën e tretë, ndërkaq, është thënë se do të vaksinohen 50 për qind e qytetarëve.

Kosova po zhvillon fushatën e imunizimit me vaksina të dhuruara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Bashkimi Evropian.

Kryeministri Albin Kurti përmes një postimi në "Instagram", duke iu referuar rezultateve të IKShPK-së, ka theksuar se u



bënë dy muaj qëkur qeveria në drejtimin e tij mori besimin e Kuvendit, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës raporton për zero raste të të vdekurve nga Covid-19. "Kjo është shtunë e rritë shpresat tona me lakoret që shënojnë rënie të

rasteve të reja dhe rritje të numrit të të vaksinuarve dhe të të shëruarve nga Covid-19", ka shkruar Kurti në ditë më parë. Kurti ka thënë se ky përparim i brishtë shumë prej nesh i gjen në pikëllimin e thellë për më të dashurit që humbëm. "Çdo jetë

e humbur nga kjo pandemi, është humbje e jona kolektive. Të qëndrojmë të bashkuar deri në ditën kur lakorja për të cilën do të flasim, do të jetë ajo e buzëqeshjes në fytyrat tona për fitoren ndaj virusit", ka shkruar Kurti.

## Përplasje në mes të policisë dhe banorëve në Shipashnicë të Kamenicës për mbylljen e një shkolle

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

KAMENICË, 23 MAJ - Në fshatin Shipashnicë e Poshtme të Komunës së Kamenicës të dielën ka ndodhur një përplasje në mes të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës dhe banorëve lidhur me një shkollë në këtë fshat e cila ishte mbyllur shkaku i reformave që ndodhën në fushën e arsimit. Policia ka përdorur sprej në drejtim të banorëve të cilët nuk kanë lejuar hyrjen e veturës së komunës e cila kishte sjellë inventar për këtë shkollë që është planifikuar të shndërrohet në çerdhe.

Lidhur me këtë rast ka reaguar edhe kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati. "Në Kamenicë vetëm 3.99 për qind e fëmijëve shkojnë në kopsht. 96 për qind të tjerë apo rreth 1 400 fëmijë qëndrojnë në shtëpi. Edhe pse edukimi parashkollor është kusht i domosdoshëm për zhvillimin e secilit fëmijë, në Kamenicë jo të gjithë e kanë këtë mundësi. Ashtu siç e kemi stërthënë, objektet e shkollave të fuzionuara do të përdoren për qëllimet më të mira për komunitetin. Dhe kështu, ne sot dërguam pajisjet dhe inventarin për çerdhen e Shipashnicës së Poshtme e cila do t'u shërbente fshatrave përreth. Është paraparë që të punësohen rreth 12 punëtorë

dhe që dy vjetët e para të jenë pa pagesë për fëmijët. Është vërtet për keqardhje deri në ç'masë është duke manipuluar komuniteti nga disa të badihavaxhinj. Nuk do ta besoja kurrë që në shekullin XXI një prind më përpara e dëgjon një manipulues sesa zemrën e tij për fëmijën e vet. Për më shumë, ministrja Nagavci me qasjen e saj po hedh benzinë në zjarr. Kjo është e turpshme dhe e pafalshme", ka shkruar kryetari Kastrati.

Në lidhje me këtë ngjarje ka reaguar kryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, i cili ka thënë se qeveria e Albin Kurtit ka nisur betejë të dhunshme me kryetarin e Kamenicës që, po ashtu, u zgjodh nga LV-ja, duke përdorur nxënësit, prindërit dhe mësuesit e Kamenicës si fushëbetë për inate e ego të sëmura pushteti. "Sot policia atje paska përdorur sprej ndaj banorëve që po mbrojnë shkollën nga mbyllja. Në vend që kryeministri e ministrja e Arsimit të ulen me kryetarin e komunës e të gjejnë zgjidhje për hapjen e shkollave në Kamenicë, ata po i përdorin nxënësit për të krijuar drama para zgjedhjeve lokale. Nxënësit duhet të kthehen në shkolla, ndërsa qeveria dhe komuna duhet t'u ofrojnë kushte sa më të mira", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".





# Kosova lë anash energjinë e gjelbër



PRISHTINË, 23 MAJ - Ka pak më shumë se dy muaj prej se Ahmet Sedefi ka investuar në vendosjen e një sistemi solar për prodhimin e energjisë elektrike mbi objektin e kompanisë së tij, "Sedefi Commerce" në Pejë. "Sipas planprogramit që e kemi si kompani, ky investim siguron që duhet të jetë i mirë dhe me përfitime për ne", thotë Sedefi për "Radion Evropa e Lirë". Njëpërmjet këtij sistemi solar, kompania që ai ka në pronësi pritet të prodhojë 100 kilovatë energji elektrike. Ky kapacitet nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjithë kërkesën e kompanisë, por Sedefi shpreson se për një periudhë njëvjeçare do të vërehet efekti i këtij investimi. "Sot për sot nuk prodhon rezultate, por pas një viti apo pesë vjetësh do të shihet rezultati. Nëse i prodhon 125 mijë kilovatë rrymë, ashtu siç e kemi në kontratë, atëherë është e favorshme. Në rastin tonë e ul koston e çmimit të produktit", ka thënë Sedefi. Sedefi thotë se shumë biznese në Kosovë nuk e kanë mundësinë që të investojnë në prodhimin e energjisë së ripërtërishme. Për këtë arsye ai thotë se do të duhej të ekzistonin grante dhe mundësi të mbështetjes financiare për bizneset që investojnë në këtë fushë.

Investimet në sisteme solare janë rritur vitet e fundit në Kosovë. Megjithatë, kompanitë që punojnë në këtë fushë thonë se duhet më shumë mbështetje dhe lehtësime.

## Energjia e ripërtërishme, sektor pa përkrahje

Ermal Imeri është drejtor i kompanisë kosovare, "ESCO Solar Systems", e cila ofron konsulentë dhe realizim të projekteve të energjisë së ripërtërishme. Imeri thotë se ky sektor përballet me procedura të shumta burokratike. "Sipas rregullave që i ka përcaktuar ZRRE-ja (Zyra e Rregullatorit të Energjisë), për të instaluar një sistem solar të lidhur në rrjet, duhet të plotësohen kushtet që i vendos distributori i energjisë, pra në këtë rast KEDS-i (Distribucioni për Furnizim me Energji Elektrike), e që këto kushte janë shumë burokratike dhe procedura shumë të vështira", ka thënë Imeri. Për të zhvilluar këtë sektor, Imeri thotë se qeveria duhet që të vendosë masa stimuluese që përfshijnë qasje më të mirë në financa për individë dhe biznese, grante si dhe ulja e taksave për kompanitë që instalojnë panele solare. "Institucionet duhet të marrin

masa stimuluese, duke filluar prej subvencionimit të një pjesë të investimeve në sisteme solare, duke filluar që ta bëjnë edhe më të thjeshtë Ligjin e shkarkimit në rrjet, duke i hequr kushtet e paarsyeshme që kërkohen të plotësohen për instalimin e sistemeve solare", ka deklaruar ai.

Përkundër mungesës së këtyre mekanizmave stimulues, Imeri thotë se investimi në energji solare është mjaft i favorshëm për klientët privatë si dhe bizneset.

## Abazi: Qeveria t'i kushtojë me shumë rëndësi sektorit të energjisë

Ditë më parë Qeveria e Kosovës miratoi programin qeverisës. Në këtë dokument, qeveria zotohet se do të kujdeset për krijimin e kushteve të favorshme "për furnizim të qëndrueshëm e të përbalueshëm me energji, për të gjithë qytetarët dhe ndërmarrjet e Kosovës, duke e pasur parasysh edhe ndikimin në mjedis". Sipas qeverisë, për të arritur këtë qëndrueshmëri, rol kryesor luan rritja e efikasitetit të energjisë dhe rritja e shumëllojshmërisë së burimeve energetike. Por, Dardan Abazi, hulumtues i lartë në Institutin për Politika

Zhvillimore (INDEP), ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se në këtë planprogram, qeveria ka përmendur vetëm kalimthi sektorin e energjisë. "Hapi i parë që qeveria duhet ta bëjë është që ta tërheqë planin qeverisës nga kuvendi dhe ta rishkruajë pjesën e energjisë, ashtu siç i takon, pra që të jetë një program i mirëfilltë ku do të ketë fillimisht pozicione të qarta të qeverisë sa i takon energjisë së ripërtërishme, efikasitetit të energjisë, reduktimit të emisioneve etj", është shprehur Abazi.

Programi qeverisës, sipas Abazit, duhet të përfshijë masa konkrete që ndikojnë në transformimin e sistemit energjetik të Kosovës. Abazi ka theksuar se Kosova duhet ta modelojë një të ardhme ndryshe në sektorin e energjisë, ku nuk varet tërësisht nga qymyri i prodhuar në Obiliq, por ku do të ketë prodhues të energjisë gjithandej Kosovës, ku edhe vetë qytetarët do të mund të jenë prodhues si dhe konsumues të energjisë. "Kështu ta realizojmë vizionin e përbashkët dekarbonizim dhe tranzicion të energjisë nga një sistem konvencional, siç e kemi të bazuar në qymyr dhe në karburante ndotëse, drejt një sistemi i cili do të jetë i bazuar në energjinë e gjelbër dhe në ruajtjen e shëndetit dhe mjedisit", ka deklaruar Abazi.

## Energjia elektrike, më e lira në Ballkan

"Radio Evropa e Lirë" ka pyetur Ministrinë e Ekonomisë për planet e reja për rritje të efikasitetit të energjisë si dhe për faktin nëse do të ketë lehtësime për bizneset dhe personat privatë që investojnë në pajisje për prodhimin e energjisë së ripërtërishme. Përkundër investimeve në burime alternative të energjisë së ripërtërishme, rreth 95 për qind energjisë elektrike në Kosovë prodhohet nga thëngjilli, 2.7 për qind nga hidrocentralet si dhe 2.3 për qind nga era dhe panelet solare. Sipas ekspertëve, nëse vazhdohet me këtë ritëm, Kosova do ta ketë të vështirë që t'i mbërrijë tragetet e vendosura nga organizatat ndërkombëtare për prodhimin e energjisë së ripërtërishme. Sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave (Eurostat), me rreth 0.06 centë për kilovat, kosovarët paguajnë më së paku në rajon për energjinë e shpenzuar. Por, deri në publikimin e këtij artikulli ky institucion nuk ka kthyer përgjigje. Sasinë më të madhe të energjisë elektrike Kosova e prodhon nga djegia e qymyrit në termocentralet e Obiliqit.



## Qeveria, thirrje qytetarëve që të aplikojnë në konkurset për ndërmarrjet publike

PRISHTINË, 23 MAJ (ER) - Qeveria e Kosovës përmes një njoftimi për media ka inkurajuar të gjithë të interesuarit nga komunitetet joshumicë, gratë dhe të interesuarit e tjerë që të aplikojnë në konkurset e hapura për plotësimin e vendeve të punës për ndërmarrjet publike. Sipas Zyrës së Kryeministrit, konkursi është i hapur për drejtor dhe anëtarë të bordeve në Trepçë dhe në Kompaninë Rajonale të Ujësjetës "Hidromorava". "Inkurajohen të gjithë të interesuarit nga komunitetet joshumicë, gratë dhe të interesuarit e tjerë, që do t'i përfaqësojnë interesat e komunës ku Trepça vepron, që të aplikojnë në konkursin për anëtarë të bordit mbikëqyrës. Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës inkurajon të gjithë të interesuarit nga komunitetet joshumicë, gratë dhe personat me nevoja të veçanta, të aplikojnë në konkursin e hapur për drejtorë të bordeve të

ndërmarrjeve publike qendrore për: Posta e Kosovës dhe Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidromorava" në Gjilan", thuhet në njoftimin për media.

Dokumentacioni i kërkuar sipas konkursit duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur, ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i ndërmarrjes publike në të cilën konkurron kandidati dhe të dorëzohen në zyrën e sekretarit të përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

Afati i konkursit për drejtorë të bordeve është deri më 10 qershor, ndërsa për anëtarë është deri më 20 qershor.

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e fundit ka miratuar bordet e reja të katër ndërmarrjeve publike. Emërimi i bordeve të përkohshme të drejtorëve të ndërmarrjes publike është bërë për ndërmarrjen Trepça, Posta e Kosovës, Korporata Energjetike e Kosovës dhe Infrakos.



## 142 092 përfitues nga skema e pensioneve bazë



Sipas raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) "Statistikat e Mirëqenies Sociale", për TM1 2021, nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 26 298 familje me gjithsej 105 296 anëtarë, dhe nga skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar 2 405 familje

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 MAJ - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e Mirëqenies Sociale" për tremujorin e parë të vitit 2021 (TM1). Ky publikim ofron të


dhëna për numrin e përfituesve nga: skema e ndihmës sociale; skema e pensioneve bazë të moshës; skema e pensioneve kontributpaguese të moshës; skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara; skema e pensioneve për personat paraplegjik dhe

tetraplegjik; skema për mbështetje materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme; skema për pensionet familjare; skema për pensionet invalidore; skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve, invalidëve të

luftës dhe veteranëve të luftës; skema e pensioneve të "Trepçës"; skema e pensioneve për Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës; skema e kompensimeve për personat e verbër; të dhënat për numrin e fëmijëve të braktisur etj.

Sipas rezultateve të dala nga ky publikim, rezultoi se gjatë periudhës TM1 2021, nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 26 298 familje me gjithsej 105 296 anëtarë dhe nga skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar 2 405 familje. Referuar këtij raporti të ASK-së, nga skemat pensionale rezultoi se: nga skema e pensioneve bazë të moshës janë 142 092 përfitues; nga skema e pensioneve kontributpaguese të moshës janë 49 165 përfitues; nga skema për pensionet familjare janë 3 700 përfitues; nga skema për pensionet invalidore janë 81 përfitues; nga skema për pensionet e "Trepçës", janë 2 272 përfitues; nga skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës janë 1 187 përfitues; nga skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës janë 590 përfitues; nga skema e kompensimeve për personat e verbër janë 1 844 përfitues; nga skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara janë 19 271 përfitues; nga skema për pensionet e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë janë 2 697 përfitues; nga skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës janë 13 487 përfitues; nga skema për veteranët e luftës janë 38 280 përfitues; dhe nga skema e viktimave civile janë 902 përfitues. Sipas ASK-së, gjatë TM1 2021 janë braktisur katër fëmijë.





Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Drita në Evropë, Arbëria bie në Ligën e Parë

Prishtina është kampione e edicionit 2020/2021. Drita ka siguruar daljen në Evropë, kurse Arbëria ka rënë në Ligën e Parë. Trepça '89 do ta kërkojë mbetjen në elitë nëpërmjet barazhit në përballjen me Dukagjinin e Klinës



pavarësisht prej këtij fakti, arriti që të përshëndetet nga Superliga me fitore. Pejanët në ndeshjen e fundit e mposhtën Gjilanin me rezultat minimal 1-0, kurse golin e vetëm e realizoi Ardit Tahiri.

SUPERLIGA		
Prishtina - Ballkani		2-5
Drita - Arbëria		2-0
Llapi - Feronikeli		1-1
Trepça '89 - Drenica		2-1
Besa - Gjilani		1-0
Tabela		
		PIKË
1. Prishtina	36	78
2. Drita	36	76
3. Ballkani	36	74
4. Gjilani	36	48
5. Llapi	36	43
6. Feronikeli	36	42
7. Drenica	36	42
8. Trepça '89	36	42
9. Arbëria	36	40
10. Besa	36	12

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 MAJ - Edicioni 2020/2021 e ka nxjerrë kampione skuadrën e Prishtinës, e cila pas tetë vjetësh ka arritur ta rikthejë në kryeqytet trofeun e më të mirit. Prishtina e siguroi titullin e kampionit një xhiro pa përfunduar kampionati, derisa në ndeshjen e fundit pësoi humbje nga Ballkani me rezultat 2-5. Mysafirët shënuan dy gola nëpërmjet Mirlind Dakut, por Prishtina e barazoi rezultatit në pjesën e parë 2-2, me golat e Besnik Krasniqit nga penalltia

dhe Endrit Krasniqit. Në pjesën e dytë Arbër Hoxha shënoi dy gola, kurse një tjetër e shtoi Blend Baftiu për rezultatit final 2-5. Pavarësisht prej këtij shkëlqimi dhe kësaj fitoreje, Ballkani edhe në këtë edicion mbetet pa dalje në garat evropiane. Ky klub që gjatë gjithë kohës ishte në garë për titull, kampionatin e mbylli në pozitën e tretë me 74 pikë të grumbulluara. Prishtina kampionatin mbylli në vendin e parë me 78 pikë të grumbulluara, ku nga 36 ndeshje regjistroi 24 fitore, 6 barazime dhe 6 humbje. Ndërsa nënkampione e Kosovës është Drita që në ndeshjen e

fundit e mposhti Arbërinë me rezultat 2-0. Gjilanasit në këtë mënyrë e siguruan pozitën e dytë që i dërgon në garat evropiane, kurse Arbëria në edicionin tjetër do të bëjë gara në Ligën e Parë. Golat për Dritën i shënuan Festim Alidema nga penalltia në pjesën e parë dhe Ardian Limani në fund të pjesës së dytë.

Feronikeli i shpëtoi barazhit, pasi barazoi në fund të ndeshjes ndaj Llapit (1-1), kurse mbetjen në elitë nëpërmjet barazhit do ta kërkojë Trepça '89, e cila, edhe përkundër fitores ndaj Drenicës (2-1), e përfundoi kampionatin në pozitën e tetë. Besa e Pejës është skuadra që më herët kishte rënë në Ligën e Parë por,

## Prishtina do të jetë bartëse në raundin preliminar të Ligës së Kampionëve



Prishtinë, 23 maj - Kampionia në fuqi e Kosovës, Prishtina, do të jetë bartëse në raundin preliminar të Ligës së Kampionëve. Klubi kryeqytetas i Kosovës i njeh edhe kundërshtarët e mundshëm në këtë rreth të garave evropiane. Organizatorët e turneut të raundit preliminar të Ligës së Kampionëve, HB Torshavn dhe Prishtina, janë bartëse nga katër skuadrat pjesëmarrëse. HB dhe Prishtina kanë nga 2 250 pikë,

kurse dy skuadrat jobartëse janë kampionët e Andorrës, Inter Club d'Escaldes me 1 500 pikë dhe kampionët e ri të San Marinos, Folgore me 1 000 pikë të tubuara, ka njoftuar klubi kryeqytetas. Pra, Prishtina në shortin e 8 qershorit mund të ndeshet me njërin prej dy skuadrave me koeficient më të ulët, Inter nga Andorra apo Folgore nga San Marino. Skuadra e San Marinos, Folgore, nga gjashtë paraqitje evropiane dhe në 12 ndeshje nuk ka asnjë kalim

raundi dhe asnjë fitore, përveç një barazimi. Do të jetë kjo vetëm pjesëmarrja e dytë e tyre në Champions. Kurse kampionët e Interit nga Andorra do ta kenë paraqitjen e dytë rresht. Të parën e kishin kundër Dritës në edicionin e kaluar duke u mposhtur nga ish-kampionët e Kosovës në Zvicër, 2-1. Në ndeshjen pasuese në Ligën e Evropës u eliminuan nga kampionët e Irlandës, Dundalk, me rezultat minimal 1-0.

## Besa dhe Istogu, fituese të Kupës së Kosovës

PRISHTINË, 23 MAJ - Besa Famgas ka vazhduar dominimin në hendbollin e Kosovës. Skuadra pejane në Istog e ka fituar Kupën e Republikës së Kosovës në hendboll. Besa Famgas në finale e mposhti Prishtinën me rezultatit 38:29. Finalja ishte e fortë dhe interesante, ndërsa Besa ka shfaqur lojë më të mirë. Prishtina është mbajtur në lojë, por pejanët gradualisht janë shkëputur në rezultat dhe kanë arritur te fitorja e thellë. Besa ka fituar më herët edhe titullin e kampionit dhe përmbyll edhe një edicion tjetër me dy trofe të fituar. Te Besa Famgas lojtari më i mirë i ndeshjes u shpall

spanjollji Victor Alonso. Ai ndeshjen e mbylli me 8 gola. 8 gola i shënoi edhe Egzon Gjuka, ndërsa kapiteni Nikolla Prce e mbylli ndeshjen me 7 gola. Te Prishtina lojtari i ndeshjes ishte portieri Armir Agushi, ndërsa lojtari më i mirë i Final4 ishte Deniz Terziqi. Ai finalen e mbylli me 13 gola. Kapitenit të Besa Famgas, Nikolla Prce, trofeun ia dorëzoi zëvendësministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani. Ndërsa KHF Istogu është fitues i Kupës së Republikës së Kosovës në hendboll. Skuadra istogase të shtunën në finale e mposhti



Prishtinën me rezultat 31:23. Ndeshja finale është luajtur në palestrën e qytetit në Istog. Pjesa e parë ishte e barabartë, ndërsa

përfundoi me epërsi të vendaseve (14:11). Ndërkohë në pjesën e dytë kanë dominuar hendbollistët e skuadrës

istogase që kanë rritur vazhdimisht epërsinë. Në fund rezultati ishte 31:23 në të mirë të Istogut. Istogu në gjysmëfinale kishte kaluar Vushtrrinë, ndërsa Prishtina ishte më e mirë se Ferizaj. Kapitenia Albina Rugova është shpallur lojtarja më e mirë te Istogu. Te Prishtina më e mira u shpall Aida Stagova. Rugova e Esma Muratović udhëhoqën Istogun me nga 7 gola. Te Prishtina më efikasja ishte Melike Ipçi me 6 gola. Nga 5 i shënuan Ivana Bojović e Stagova. Kupën kapitenes së Istogut, Albina Rugova ia dorëzoi nënpresidenti i FHK-së, Enis Idrizi.



## Simeone: Ishte viti i duhur për ta fituar La Ligën

MADRID, 23 MAJ - Atletico Madridi është kampion i Spanjës. "Colchoneros" kthehet ta festojë fitoren e La Ligas shtatë vjet pas suksesit të fundit. Kryevepra mban përsëri firmën e Diego Simeones. Trajneri ka folur për DAZN pas ndeshjes së

fituar ndaj Valladolidit. "Ndjesia e parë është se është kaq e vështirë: me miq që janë larguar, me tifozë të Atletico Madridit që nuk janë më. Fakti që kemi shpallur kampionë në këtë sezon i jep një shije tjetër. Ka qenë viti më i mirë për ta fituar

kampionatin", ka thënë trajneri argjentinas. "Kur gjyqtari ka vërshtëllur fundin e ndeshjes, para së gjithash kam qeshur: ka qenë e natyrshme, nuk e di pse. Pas pak do të përqafohem me tifozët. Më vjen keq që nuk janë këtu". Ndryshimet me

titullin e fituar në 2014-n: "Është ndryshe, janë momente të tjerë. Ajo që po kalon bota sot është një moment shumë i trishtë dhe i vështirë. Të paktën kemi arritur t'u japim pak gëzim shumë njerëzve që kanë kaluar çaste të vështira".



## Curry nuk mjafton, Grizzlies eliminon Warriorsin

SAN FRANCISCO, 23 MAJ - Ekipi i Memphis Grizzliesit eliminoi "franchise"-n e tretë më të suksesshëm në historinë e NBA-s teksa ia doli për ta mposhtur brenda në Kaliforni skuadrën e Golden State Warriorsit. Një ndeshje vërtet e madhe që reflekton në mënyrën më të mirë të mundshme atmosferën që përcjellin sfidat e mëdha me eliminim të drejtpërdrejtë, në kampionatin më spektakolar në planet. Një kualifikim plotësisht i merituar për ekipin nga Tennessee, që arriti ta thyejë skuadrën e drejtuar nga trajneri i mirënjohur Steve Kerr brenda në San Francisco. Një triumf i jashtëzakonshëm për Grizzlies, që u regjistrua pas kohës shtesë dhe për më tepër jashtë fushës së tyre. Siç dihet, Warriorsi ka marrë pjesë në pesë finale radhazi në gjashtë edicionet e fundit të NBA-s, duke u kurorëzuar tri herë me trofeun Larry O'Brien, por këto janë kohë vërtet shumë të vështira për skuadrën dhe tifozët e tyre. Pasi u mund në serinë e finaleve në vitin 2019 nga Toronto Raptors, ku Golden State humbi yllin e skuadrës Kevin Durant, për një dëmtim të rëndë në tendinën e akilit, "franchise" i mirënjohur kalifornian la Oaklandin për t'u zhvendosur në San Francisco, megjithatë që nga ajo kohë ekipi ka vuajtur ndryshime për shkak të ndryshimeve të mëdha dhe problemeve të shumta që shkaktuan dëmtimet e lojtarëve më të rëndësishëm të skuadrës. Sezonin e kaluar Warriorsi nuk u kualifikua fare për në fazën përfundimtare të "play off"-it, ndërsa këtë herë, pas shumë e shumë mundimeve, ekipi ia doli për ta mbyllur sezonin e rregullt në vendin e katërt në Divizionin e Paqësorit, me bilancin 39 fitore e 33 humbje. Me një bilanc të tillë skuadra e Steve Kerr u përplas herët pikërisht me kampionët në fuqi dhe në "Staples Center", ekipi i Los Angeles Lakersit fitoi ngushtë 103-100, me një kosh përcaktues të realizuar nga



"periferia" nga ylli i "liqenoreve" LeBron James. Në krahun tjetër Grizzlies e përfundoi sezonin e rregullt në Divizionin e Jugperëndimit në pozicionin e dytë, me 38 fitore e 34 humbje dhe ekipi i drejtuar nga trajneri Taylor Jenkins mundi në "FedExForum" 100-96 skuadrën e San Antonio Spursit. Sipas rregullores së re, Golden State pati edhe një mundësi të dytë, pikërisht në përballjen e fundit të ashtuquajtur "play-in", në Konferencën e Perëndimit, në një takim të drejtpërdrejtë me Memphis Grizzlies, duke pasur madje edhe favorin e faktorit fushë. Në "Chase Center" të San Franciscos, përpara 7 505 spektatorëve dy ekipet u ndeshën për herë të katërt në këtë sezon, me vendasit që kryesonin bilancin, falë dy fitoreve në tri sfidat ndërmjet tyre. Si për ironi të fatit, dy skuadrat ishin përballur vetëm 6 ditë para këtij dueli, në takimin përfundimtar të sezonit të rregullt, ndeshje që u fitua nga Warriorsi me shifrat 113-101. Këtë herë basketbollistët e ekipit nga Tennessee udhëhoqën pothuajse gjatë gjithë kohës nga fillimi në fund dhe përjashtim në rezultat bëjnë vetëm avantazhet e periodes hapëse 2-0, 4-3 dhe 27-26. Në 12' e dytë miqtë "fluturuan" në epërsinë e 17 pikëve, 59-42, ndërsa në interval dy skuadrat shkuan me avantazhin e Grizzlies 62-49. Vendasit të përkrahur edhe nga publiku i tyre i zjarrtë reagues dhe ngushtuan diferencën në 78-

73 në fundin e periodes së tretë, sidoqoftë në 12' përmbyllës ekipi nga Memphis u shkëput sërish, për të shkuar deri në +10, 95-85, raporton "Supersport". Skuadra e Steve Kerrit përmirësoi ndeshëm mbrojtjen falë rezultatit të pjesshëm 12-2 për ta barazuar rezultatin në shifrat 97-97, ndërsa në fund pikërisht në sirenë Draymond Green u bllokua nga mbrojtësit kundërshtarë, duke shpërdoruar kështu edhe mundësinë për ta fituar takimin. Me shifrat 99-99 dy ekipet shkuan në kohën shtesë dhe në overtime miqtë përsëri dominuan në rezultat. I vetmi moment kur Warriorsi e pa veten përpara ishte 1'50" para fundit, kur Golden State mori kryesimin 109-107, gjithsesi 21-vjeçari nga Karolina e Jugut. Ja Morant, ishte thjesht i papërmbyllshëm dhe udhëhoqi ekipin e tij drejt një suksesi vërtet të jashtëzakonshëm me shifrat 117-112. Basketbollisti me mesataren më të lartë përgjatë edicionit të rregullt, 32 pikë për ndeshje, i shpallur dy herë si MVP në vitet 2015 e 2016, 33-vjeçari nga Akroni i Ohios, Steph Curry, e mbylli mbremjen me plot 39 pikë, në diçka më shumë se 47', ndërsa Morant shkëlqeu për Grizzlies me 35 pikë, 6 topa të rikuperuar dhe 6 asistime në afërsisht 46' që qëndroi gjithsej në parket. Memphis hyn me numrin 8 në shortin kryesor në Konferencën e Perëndimit, ku do të përballet me ekipin më të mirë në sezonin e rregullt, Utah Jazz, që e përfundoi sezonin e rregullt me 52 fitore e vetëm 20 humbje.

### SHKURT

#### Më 24 korrik përballet Fury - Wilder

Tyson Fury do të ndeshet me Deontay Wilderin më 24 korrik në Las Vegas. Meçi me Anthony Joshua nuk do të zhvillohet, derisa u bë zyrtar lajmi se WBO ka urdhëruar Joshua ta mbrojë titullin kundër Oleksandr Usyk. Fury do të përballet me Wilderin dhe tani është zyrtarë, pasi arbitrazhi kishte vendosur që Fury duhet të luftojë ndaj Deontay Wilderit edhe për një herë sipas një marrëveshje dypalëshe. Fury ka nënshkruar kontratën e cila parasheh që meçi të zhvillohet më 24 korrik duke porositur se do ta mposhtë Wilderin edhe një herë.

#### 21 vrapues humbin jetën gjatë një maratone në Kinë

21 vrapues në një garë maratonë malore kanë vdekur në Kinë veriperëndimore pasi i ftohti, breshri, shiu dhe erërat e furishme goditën pistën, njoftoi media shtetërore të dielën (23 maj). Selia shpëtimt e cituar nga Agjencia Zyrtare e Lajmeve Xinhua tha se pjesëmarrësit vuanin nga shqetësimi fizik dhe rënia e papritur e temperaturës. Herët të dielën, ekipet e shpëtimt gjetën 21 të vdekur. Operacioni u bë i vështirë nga temperaturat e ulëta dhe terreni kompleks dhe topografia. Vrapuesit po garonin në një shteg jashtëzakonisht të ngushtë malor në lartësi, tha një reporter për transmetuesin shtetëror CCTV. "Një total prej 172 personash ishin bashkuar në garë dhe 151 janë konfirmuar të jenë të sigurt. Disa u trajtuan për dëmtime të lehta dhe ishin jashtë rrezikut për jetë", ka njoftuar Xinhua.

#### Suarezi: Barcelona më poshtëroi, i jam mirënjohës Atletico

Barcelona e konsideroi të padobishëm dhe e ndau nga miku i tij i madh, Lionel Messi. Simeone e priti krahëhapur tek Atletico e Madridit, besim të cilin "El Pistolero" e shpërbleu si golashënuesi më i mirë i skuadrës me 21 finalizime në 32 ndeshje të kampionatit. Luis Suarez do ta mbajë mend këtë sezon për një kohë të gjatë. "Ky ishte viti më i vështirë për mua. Barcelona më hodhi poshtë dhe më poshtëroi, por unë nuk e ula kokën. I jam mirënjohës Atletico që ma dha këtë shans. Shumë na kanë nënvlerësuar, ne ishim ekipi më i qëndrueshëm dhe për këtë arsye më i miri. Ne dimë të vuajmë dhe në fund fitojmë", ka thënë Suarez. "Nuk ishte viti më i mirë për ta fituar kampionatin. Të shpalleh kampion një vit si ky, me shumë miq të larguar përfundimisht dhe pa praninë e tifozëve të shumtë të Atletico... do të kishte shije tjetër. Për fat të mirë, ne mund të sjellim pak gëzim në një moment kaq të vështirë dhe të trishtuar për botën", ka deklaruar Suarez.

#### Chelsea, ofertë të 'çmendur' për Kane

Chelsea është duke kërkuar një sulmues të klasës së lartë. Në fillim ishte Lukaku për të cilin Abramovich do ta hapte thesin me një ofertë mbi 100 milionë paund, më pas Lewandowski mundësitë me të cilin ishin vetëm nëse do të ishte dakord Bayerni, por tashmë duket se Harry Kane është objektivi kryesor. Mediat angleze aludojnë se Chelsea është gati t'i japin Tottenhamit dy lojtarë, Kepa Arrizabalagan dhe sulmuesin talent, Tammy Abraham, plus para për t'i marrë shërbimet e 27-vjeçarit. Kane është thuar se i larguar nga Tottenhami pasi i ka kërkuar klubit të ikë dhe këta të fundit janë dakord. Gjithsesi duket se Kane ka një dëshirë për të shkuar te Manchester City duke qenë se vetë deklaroi se lojtari perfekt me të cilin do të donte të luante ishte Kevin De Bruyne.

## Lewandowski, pasi theu rekordin e Mullerit: Shënova në momentin kur nuk e prisja

Robert Lewandowski në ndeshjen e fundit të Bundesligës hyri në histori. Polaku arriti kuotën e 41 golave dhe theu rekordin 49-vjeçar të Gerd Mullerit si lojtari që ka shënuar më shumë gola brenda një edicioni në

historinë e Bundesligas. "Nuk kam fjalë për këtë rekord. U përpoqa gjatë gjithë ndeshjes të shënoj, provova gjithçka dhe ia arrita në minutën e 90. Jam shumë i lumtur. Pashë që Sane po gjuante, kështu që shkova të

shoh nga portieri. Sigurisht, doja të shënoja më parë, por e dija se në një moment rrjeta do të vinte. Falënderoj shokët e mi të skuadrës që u përpoqën në çdo mënyrë për të më bërë të shënoja. Nuk isha i zemëruar,

thjesht isha zhgënjyer sepse nuk mund të shënoja. Kur pyesja veten përse nuk po shënoja, atëherë erdhi goli. Ky rekord është edhe i shokëve të mi, i falënderoj ata", ka thënë Lewandowski.





**MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO**

**SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)**

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Judicial Open Data Consultant
Procurement Ref. Number	IC/ MFK/2021/009
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Services
Employer	Millennium Foundation Kosovo (MFK)
Publication Date	21 May 2021
Submission Deadline	03 June 2021; 16:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo (MFK), has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The MFK, the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for selection of an individual consultant for Judicial Open Data Consultant.

The main objective of this assignment is to (1) clean and structure the datasets from private/public entities of the judicial sector in Kosovo in open data readable formats such as XLS or CSV, in accordance with the needs of these entities, (2) develop and deliver the data portion of the Judicial Dig Data Stakeholders Workshop, (3) develop a manual/guidebook for Judicial Dig Data Challenge, (4) develop a data analysis illustration to be used in the application form of the Judicial Dig Data Challenge.

A primary focus of this assignment is to build an open machine-readable database of the data available in the judicial sector, from entities that collect and generate analysis on this data, in order for civil society, the private sector, individuals and other related stakeholders to obtain and analyze this data.

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the Threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MFK, money is already available to the MFK and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites Individual Consultant to provide the consultant services referenced above ("Proposals"). More details on these consultant services are provided in the Terms of Reference.

This LOI is open to all eligible entities ("Individual Consultant") who wish to respond. Subject to restrictions noted in the LOI.

A Consultant will be selected under the Individual Consultant Selection (IC), the evaluation procedure for which is described in sections of the LOI in accordance with "MCC Program Procurement Guidelines" which are provided on the MCC website ([www.mcc.gov/ppg](http://www.mcc.gov/ppg)). The selection process, as described, will include a review and verification of qualifications and past performance, including a reference check, prior to the contract award.

A complete set of Letter for Invitation (LOI) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible consultants:

<https://millenniumkosovo.org/procurement/judicial-open-data-consultant-ic-mfk-2021-009>


Consultants interested in submitting a proposal should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the LOI to the Procurement manager at [procurement@millenniumkosovo.org](mailto:procurement@millenniumkosovo.org), giving full contact details of the consultants.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in LOI rejection. The File link for submission of qualifications is included in the LOI document.

Applications shall be submitted ONLY to the file request link provided in LOI documents no later than **03 June 2021; 16:00pm (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

<b>The address referred to above is:</b>	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Attn:</b>	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Tel:</b>	00 383 38 752 110
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:procurement@millenniumkosovo.org">procurement@millenniumkosovo.org</a>
<b>Website:</b>	<a href="http://www.millenniumkosovo.org">www.millenniumkosovo.org</a>



# Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejepuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Mehmet Temaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Bajram Curi " Romaje.

► Enver Gashi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

